REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 5057/1 **Prot** **Lushnje, më** 14.06 **2024**

PROJEKT- VENDIM

Nr. 62 **Datë** 14 **/06/ 2024**

"MBI NJË NDRYSHIM TË BUXHETIT TË VITIT 2024 "

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës / 06 /2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari Bashkisë,Qendra e Arsimit ", si dhe mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54,neni 8 pika 2,neni 33 pika 3,neni 41 Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, neni 44, në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" pika 100 -a .

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë investimin me objekt: "Blerje mjet transporti(kamioncinë) " me vlerë 1 000 000 lekë,për Ndërmarrjen Qendra e Arsimit .
2. Të miratojë përdorimin e fondit prej 1,000,000 lekë në vitin 2024, duke lëvizur nga zëri i parashikuar për programin AB129 artikullin 602 (Bashkia Lushnje)në programin AC129 në artikullin 231(Qendra e Arsimit ,Kodi do të celet nga MF)
3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finance-Buxhetit, Qendra e Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për Qendren e Arsimit
Muarrem SHARKA

Drejtori Juridik
Bedri HIDA

KRYETARI BASHKISE
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

5031
13.06.2024.

M. Fimo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE
QENDRA E ARSIMIT

Nr. 263 **Prot** **Data:** 13.06. **2024**

Lënda: Relacion

Drejtuar: Kryetares së Bashkisë Lushnje znj Eriselda Sefa

Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje, një nga objektivat e punës së saj ka mirëmbajtjen, riparimin dhe rikonstruksionin e çerdheve, kopshteve, shkollave, dhe institucioneve të tjera publike. Harta e vendosjes së objekteve të institucioneve publike përfshin të gjithë territorin e Bashkisë Lushnje.

Në kuadër të përmirësimit të procesit të punës dhe rritjen e kushteve për mirëmbajtjen e objekteve në institucionet arsimore dhe në institucionet e tjera publike, e shohim të nevojshëm pajisjen e Qendrës së Arsimit Bashkia Lushnje, me një mjet transporti (kamioçinë), për transportimin e materialeve dhe punëtorëve, në destinacionet përkatëse sipas nevojave të procesit të punës.

Është një nevojë e hershme, përcaktuar nga detyrimi ligjor që ka institucioni për kryerjen në kohë dhe me cilësi të shërbimeve në objektet publike, duke ditur që aktualisht Qendra e Arsimit disponon një mjet transporti për kryejen e shërbimeve të kërkuara.

Në pamundësi për të financuar blerjen e mjetit në planifikimin e buxhetit të vitit aktual, e shohim të arsyeshme që me rishikimin e tij, t'i akordohet Qendrës së Arsimit një fond me vlerë 1000 000 lekë për blerjen e mjetit.

Ju faleminderit!

DREJTORI

Muarrem Sharka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA E ARSIMIT
BASHKIA LUSHNJE

QENDRA E ARSIMIT

Te dhenat teknike te kamioncines veteshkarkuese

TE DHENAT TEKNIKE TE KAMIONCINES		
1	Sasia	1 cope
2	Gjendja	E perdorur
3	Tipi/Kategoria	Veteshkarkues
4	Viti prodhimit	Jo me I vjeter se 2007
5	Fuqia Moterrike	Jo me pak se 81 HP (2148cc)
6	Karburanti	Nafte (diesel)
7	Standarti I emertimit te gazrave	Minimumi Euro 5
8	Kambio	Manual ose automatik
9	Numri I akseve	2
10	Konfigurimi I akseve	4 x 2
11	Kabina	Me 4 dyer dhe 4+1
12	Kapaciteti mbartes	Jo me shume se 3500 Kg
13	Motorri	Gjendje te mire pune
14	Pjeset xhenerike	Gjendje te mire pune
15	Sistemi I frenimit	Gjendje te mire pune
16	Sistemi I drejtimit	Gjendje te mire pune
17	Gomat	Gjendje te mire pune
18	Sistemi elektrik	Gjendje te mire pune

Dokumentacioni

Te jetei pajisu me dokumentacion regjistrimi ku perfshihen (leje qarkullimi, targa, taksa)